



Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2 pika d) të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008) dhe nenit 11 të Udhëzimit administrativ, Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 13 të Rregullores për Transparencë në Komunën e Klinës legjislacionin tjetër në fuqi, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e VI të rregullt, të mbajtur më datën 29/6/2017, miratoi këtë:

V E N D I M

Për

Miratim të Planit të Veprimit Për Transparencë në Komunën e Klinës

I

Miratohet Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës për vitin 2017.

II

Plani si në pikën 1 të këtij vendimi ka synim që t'i ofroj publikut qasje në monitorim dhe zbatim të akteve të komunës, duke përfshirë edhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, prokurimit dhe sferave tjera të cilat janë në interes për publikun.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës për vitin 2017 me 01 nr.06-3578/17 dt.04.07.2017.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL dhe nenit 18 të Rregullores së Qeverisë së RKS Nr.01/2013.

Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Zyra për Informim, Zyra Ligjore, Një kopje për Shërbimin për punë të Kuvendit dhe një Kopje për Arkivin e Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01N/ 06-3786 /2017
Klinë, me 20.07 2017

